



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:143205  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05497679

**P.nr.150/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** – Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues Ali Kutllovci, me antarët e trupit gjykues – gjyqtarët: Xhemajl Jusufi dhe Leart Rexhaj, me zyrtaren ligjore-procesmbajtësen Shukrije Selimi, në çështjen penale ndaj të pandehurit S.Z, i akuzuar për veprat penale Vrasje e Rëndë në tentativë, nga neni 173 par.1 nënpar.1.5 e 1.11 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve, nga neni 366 par.1 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, PPI.nr.107/2023 te datës 29.08.2023. Të rikualifikuara nga ana e prokurorit të shtetit në fjalën përfundimtare në veprat penale: Vrasje në tentativë, nga neni 172 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, pastaj duke krijuar një dispozitiv të ri për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së, ndërsa ka mbetë vepra penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve, nga neni 366 par.1 i KPRK-së. Pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në prezencën e palëve: Prokurorit të shtetit në PTH – Mitrovicë Njazi Rexha, të pandehurit S.Z dhe mbrojtësit të tij av. Nexhat Beqiri. Trupi gjykues, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, jashtë seancës e ka ri-kualifikuar veprën penale të rikualifikuar nga prokurori, nga vepra penale: Vrasje në tentativë nga neni 172 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, në veprën penale: Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.2 e lidhur me par.2 nënpar.2.1 të KPRK-së. Seanca ka qenë e hapur për publikun. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor më dt.01.04.2024, Gjykata ka shpallur publikisht aktgjykimin me datën 04.03.2024, ndërsa me dt.25.03.2024, ka përpiluar me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Kundër të akuzuarit:**

**S.Z**, nga i ati Sh..., e ëma F..., e gjinis A..., “data e lindjes”, në fshatin...-Komuna e Vushtrris, ku edhe tani jeton, rruga ‘‘Sh...Z...’’, i martuar, baba i 5 fëmijve të mitur, ka të kryer shkollën e

mesme ekonomike, ishte puntor në kompanin "B....", i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal...., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar, nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale, në paraburgim nga dt.27.06.2023.

## ËSHTË FAJTOR

### I. Sepse:

Me datën 27.06.2023 rreth orës 13.52 min, në fshatin....-Komuna e Vushtrris, saktësisht në kompanin "B..." me dashje i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarin E.O, ashtu që pas një mosmarrveshje të atqasëshme, fillimisht i pandehuri hedhë një qekan në drejtim të dëmtuarit, pastaj niset drejt dollapit personal ku i kishte gjësendet e tijë nga ku e nxjerr revolen e tipit "Ceska Zbrojovka " model 50, e cal, 7.65 x17 mm me nr serik C... të cilën e reperton aty për aty dhe ja drejton në kokë të dëmtuarit E.O, i cili në atë moment tenton t'ja kap armen nga duart dhe e shtynë poshtë, e në atë moment i pandehuri shtie në drejtim të dëmtuarit E.O ku predha e godet në pjesën e abdomneit – barkut me që rast të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor dhe të rrezikshëm për jetën në momentin e shkaktimit .

**- Me këtë ka kryer veprën penale:** *Lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par 3 nënpar 3.2 e lidhur me par 2 nënpar 2.1 të KPRK-së.*

### II. Sepse:

Me dt. 27.06.2023 rreth orës 13.52 min në fshatin S...- Komuna e Vushtrris në kompanin "B..." me qëllim të shkaktimit të lëndimeve trupore të dëmtuarit A.I shtënë më pistolet të kalibrit 7.65 x17 mm, në drejtim të këmbëve me që rast e godet në këmbën e majtë në pjesën e sipërme të mbigjurit dhe i shkaktonte lëndime të lehta trupore me pasoja të përkoshme shëndetsore.

**-Me këtë ka kryer veprën penale:** *Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së.*

### III. Sepse:

I pandehuri me datën dhe kohën e cekur në pikën I të dispozitivit të aktakuzës ka mbajtur në pronësi armen e tipit VZOR 50 cal, 7.65 mm me numer serik C... pa leje përkatëse dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët e cila edhe është përdorur ditën kritike si në dispozitivin numer I të kësaj aktakuze e të cilën armë ja ka dorëzuar policisë në momentin që kanë mbërritur në vendin e ngjarjes dhe e njëjta është sekuestruar.

**-Me këtë ka kryer veprën penale:** *Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit; 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 38, 40, 42, 69, 79 si dhe neneve 186 par 3 nënpar 3.2 e lidhur me par 2 nënpar 3.1 të KPRK-së, nenit 185 par 2 lidhur me par 1 nenit 366 par 1 të KPRK-së dhe nenin 364 e 365, 449, 452, 462 par.2 të KPP-ës, të pandehurit S.Z, i

## **SHQIPTON**

**-Për veprën penale** *Lëndimi i rëndë trupor, nga neni 186 par.3 nënpar.3.2 e lidhur me par.2 nënpar.3.1 të KPRK-së, i shqiptohet DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej tre (3) vjet.*

**-Për veprën penale** *Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së, i shqiptohet DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj.*

**-Për veprën penale** *Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i shqiptohet DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj.*

**Në bazë të nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.2 të KPRK-së, të akuzuarit S.Z, gjykata i**

**SHQIPTON**-Dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) vjet e tetë (8) muaj i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merrë formën e prerë.

Të akuzuarit S.Z, koha e kaluar në masën e paraburgimit prej dt.27.06.2023 deri me dt.04.03.2024, i llogaritet në dënimin e shqiptuar unik me burgim.

**Lidhur me konfiskimin:**

Në mbështetje të nenit 276 të KPP-së, URDHËROHET që në mënyrë të përhershme t'i konfiskohet Arma-revole e tipit VZOR 50 cal 7.65 mm me nr serik C..., e cila pasi që aktgjykimi të merrë formën e prerë do të shkatërrohet nga Policia e Kosovës.

### **Lidhur me paraburgimin:**

Të akuzuarit me aktvendim të veçantë të ndërpritet masa e paraburgimit që nga data e sotme, data 04.03.2024.

### **Shpenzimet e procedurës**

Në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumen prej njëqind e peshjet euro (150) për ekspertizen mjeko ligjore, në emër të paushallit të paushallit gjyqësor shumen në lartësi prej njëzet (20) euro, dhe në emër të Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit shumen prej pesëdhjetë (50) euro, të cilat është i obliguar i denuari që t'i paguaj në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

### **Kërkesë pasurore juridike:**

Palët e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

## **A r s y e t i m**

### **Aktakuza:**

Më 29 Gusht 2023, Prokuroria Themelore në Mitrovicë Departamenti i krimeve të rënda, ka ngritur aktakuzën PPI.nr.107/2023 të datës 29.08.2023, kundër të akuzuarit S.Z , për veprat penale: Vrasje e rëndë në tentative nga neni 173 par 1 nenp 1.5 e 1.11 e lidhur me nnein 28 të KPRK-së dhe vepres penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par 1 i KPRK-së

### **Seanca e shqyrtimit gjyqësor:**

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancen e shqyrtimit fillestar me dt. 12.09.2023 në të cilën senci i pandehuri e ka pranuar fajsinë për vepren penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par 1 i KPRK-së, i cili pranim i fajsisë është miratuar nga ana e gjykatës.

Mbrojtësi i të pandehurit ka parashtruar Propozimin për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.

Me aktvendimin P.nr.150/23 dt. 31.10.2023 Kryetari i trupit gjykues e ka refuzuar propozimin e mbrojtësit për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave. Mbrojtësi nuk ka parashtruar ankes kundër këtij aktvendimi.

Për këtë çështje penale janë caktuar dhe mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor me dt.126.01.2024,22.02.2024, 01.03.2024. Seancat e shqyrtimit gjyqësor kane qenë te hapura për publikun. Shpallja publike e aktgjykimit është bere me dt.04.03.2024, ne munges të palëve .

Në secilin prej shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura, gjykata të akuzuarin e ka njoftuar me të drejtat e tij në cilësinë e palës së akuzuar. I njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe për mbrojtës sipas autorizimit e kishte av.Nexhat Beqiri.

### **Prezenca e palëve në shqyrtimin gjyqësor:**

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka prezantuar Prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë, Njazi Rexha, i pandehuri S.Z dhe mbrojtësi i tij av.Nexhat Beqiri .

### **Pretendimet e palëve- Fjala përfundimtare:**

**Prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë Njazi Rexha, në fjalën përfundimtare deklaroi se** pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe adminsitrimin të provave rezulton se ndryshon gjendja faktike e paraqitur ne shqyrtimin gjyqësor nga ajo që është përshkruar ne dispozitivin e aktakuzës e kjo vërtetohet nga deklarata e dëshmitari E.O, A.I, dhe nga vet deklarata e te pandehurit S.Z, mbi këtë bazë edhe bëj ndryshim ne dispozitivin numër 1 të aktakuzës ashtu që fshihet fjala “të dëmtuarit” duhet jetë “ i dëmtuari E.O”, dhe pastaj fshihet fjala “ dhe A.I” po ashtu në fillim të rendit të pestë ne vend të “të dëmtuarve” të shënohet “ të demtuarit” vazhdon teksti vijues deri në përfundimin e rendit të 10 “në momentin e shkaktimit” fshihet teksti vijues dhe duhet të shënohet me kete ka kryer veprën penale Vrasje ne tentativë nga neni 172 e ldhur me nenin 28 të KPRK-së.

Shtojmë dispozitiv te ri: me datën 27.06.2023 rreth orës 13:52 minuta në fshatin Stanofvc komuna e Vushtrrise me kompanine “B...” me qëllim të shkaktimit te lëndimeve trupore të dëmtuarit A.I shtënë me pistoletë kalibrit të 7.65mm x 17mm në drejtim te kembeve me crast e godet ne kemben e majtë në pjesën e sipërme të mbi gjurit dhe i shkakon lëndime të lehta trupore. Me këtë ka kryer veprën penale Lendimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

Akuza të pandehurin e ka nagrkuar me Vrasje të rëndë pika 1.5 dhe 1.11 .Vepra penale e vrasjen së rëndë nga pika 1.5 konsiderohet kur kryerësi për kryerjen e vepres penal përdor ose vepron ne aso rrethanash dhe vënë ne rrezik jeten e nje ose me shumë personave perveq atij ndaj të cilit është drejtuar veprimi i kryerjes.

Ne rastin konkret ne vendngjarje nuk ka qenë askush përveq te dy te demtuarve dhe vet te pandehurit, dhe per ekzistimin e kesaj vepre penale duhe te ekzistojë rreziku konkret e që mungon në rastin e tillë.

Tek vepra penale vrasja e rende pika 1.11, ky lloj i vrasjes konsiderohet se është kryer në rastet kur kryesrësi me dashje ka privuar nga jeta dy ose më shume persona, në rastin konkret nuk mund të themi se dashja e te pandehurit ka qene që ta privoj nga jeta te dëmtuarin A.I, pasi që nga deklarata e te demturit A.I dhene ne shqyrtimin gjyqesor rezulton se i pandehuri ka shtene me pistolet ne drejtimin e kembeve te tij, se lendimet i ka pesuar ne kembe , se ka shtene vetem nje here dhe se nuk ka pasur asnje pengese qe ai mos te mund te vazhdoi me te shtena te armes dhe se distanca mes tyre ka qene 4-5 metra. Nuk eshtge kontestuese se mes te pandehurit S.Z dhe te demtuarve E.O dhe A.I ka pasur provokime si rezultat i tyre dhe i pandehuri S.Z fillimisht hudhe dalten ne drejtim te demtuarit E.O pastaj shkon te dollapi merr pistoleten drejton te demtuarit E.O dhe shkrep ne te e pastaj me te njejten shtene edhe ne te demtuarin A.I kjo gjendje faktike vertetohet nga xhirmet e kamaerave ku shihen veprimet e te pandehurit dhe sulmi i paporovkuar nga ana e te demtuarve se E.O dhe A.I kane pesuar lendime trupor nga tge shtenat e armneve qe vertetohet nga raporti mjeksor i Institutit te mjekesise ligjore nga i cili rezultone se E.O ka pesuar lendime trupore ne pjesen e abdomenti lendime me pasoje te perhershme ne shendet, ndersa A.I lendime ne kemben e majte ne pjesen e siperme te gjurit. Se lendimet te demtuareve ju jane shkaktuar nga perdorimi i armes kjo rezultone edhe nga sekuestrimi i armes nga na e te pandehurit e po ashtu edhe nga ekspertiza balistike nga e cila rezultone se pistolete gjate gjujteve testuese ka qene funksionale dhe gjujtjet i realizone ne menyre gjysematomatike. Bazuar ne krahsimet e bere mikroskopike ne mes te dy gezhojav e te lalibrut 7,65 dhe deshmive D9 dhe D11 gezhojat e qitjeve testuese te qitura nga pistolet evidentuar si E n pistolet e sekuestruar nga i pandehuri ka rezultuar se keto dy gezhoja jane shkrepur nga pistolet qe eshte e sekuestruar nga i pandehur. Nga fotodokumentacioni i vendit tge ngjarjes shihet vendi i ngjarjes , gezhojat e gjetura ne vendin e ngjarjes , njollat e kuqe te gjakut si dhe pistoleta me te cilen eshte kryer vepra penale. Gjithashtu edhe raproti i keqyrjes se vendit te ngjarjes tregon se vendi i ngjarjes ka qene ne kompanin “B...”.

Deklarimi i te pandehurit se shkrepja e aremes eshte ne menyre aksidentale eshte i pabaze pa argumentuar orijentuar me qellim shmangejes nga ndjekja penale pasi kjo vertetohet ne fakte se pas hedhjes se daltes ne drjetim te demtuarit ka mundesi qe i njejti te largohet ng avendi i ngjarjes,

mirepo i njejt shpreh kembengulsin , ne realiziumin e qellimit duke shkuar tek dollapi marre pistoleten dhe shkrep ne drejtim te demtuareve.

Nga te gjitha keto rezulton se i pandehuri me pamedyshje ka kryer veprat penale per te cilat ngarkohet andaj i propozojme gjykates qe te pandehurin ta shpall fajtor per veprat e kryera penale e ne rastin e ckatimit te llojit dhe lartesis se denimit ti kete parasysh rrethant lehetesuese dhe ato renduese te parapara me ligj, veqenarisht si rrethane renduese ta maerr parasysh se nga dosja kriminale rezulton se i pandehri eshte i prirur te kryej vepra penale kunder jetes dhe trupit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit E.O, Av.Fatbardh Makolli, në fjalën përfundimtare deklaron: une fjalën përfundimtare e kam te pergaditur ne formen e shkruar e cila eshte ne dy faqe te formatit A4 e te cilat ja dorezoi gjykates dhe paleve nga nje kopje. I njejt shtone se pala e demtuar nuk pajtohet me ricilsimin e bere nga prokurori ne kete senac dhe ja leme gjykates qe te vendos konform nenit 359 par. 2 te KPPK.

Mbrojtësi i të pandehurit S.Z, Av.Nexhat Beqiri, në fjalën përfundimtare deklaron: se fjalën përfundimtare e ka pergaditur ne forme te shkruar ne tri faqe te formatit A4 te cilat nga nje kopje ua dorezoi paleve dhe gjykates, ndersa sa i perket ndruyshimit te kualifikmit nga prokurori do te deklarohem shkurtimisht i cili dekalrone. Ne fjalën përfudnimtare ju kame referuar vepres penale vresje e rende siç ka qene ne aktakuze , ndersa tani kerkoj qe te hiqet vrasje e rende dhe te mbetget ashtu siq deklaorin PTh ne tersi. E kundrshtoi nje pretendim te tille te PTH sa i perket vrasjes per faktin se me asnje prove nuk vertetohet se i mbrojturi im pat dashje qe ta privoje nga jeta te dmetuarin E.O. Po qe se shiqohet videoja e inqizimit nuk mund te vertetohet momenti i shtenjes me arme dhe si ndodhi ajo, andaj gjykates i propozoje qe ta kete parasysh parimin(indubio proreo) gjithashtu duhet te theksohet se ai fillimisht mur armen dhe dalten qe gjuajti ne menyre qe ti nderpreses provokimet por siq e tha edhe ai vazhdoi me sharje dhe provokime, po te ishte qellimi i vrasjes nga lartesia 3-4 metra ai do ta privonte pa u ofruar fare te i demtuar. Andaj konsideroi se nuk permbushen elementet e firures se vepres penale vrasje por lendim i rende trupor siq eshte konstatuar ne ekspertize mjeko ligjore. Sa i perket lendim i lehte trupor i mbrojturi im edhe ne kete faze pajtohet me kete cilesim por kjo ka ndhur ne afet sepse ishte i tronditur nga gjendje emocionale e shkaktuar nga shkrepaj e pare e armes. Gjykates i propozojme qe si rrethane lehtesuese ta merr menyren e kryuerjes sepse dashja nuk ishte vrasja , pranimin e fjasidse sa i perketg dy verpa tjera lendimin e lehte dhe armembajtjen pa leje, rrethanen se e ka te semuar vajzen nga nje semundje kronike mjaft te rende , eshte i vetmi

mbajtes i familjes 6 anetareshe ashtu qe me rastin e shqiptimit llojit dhe lartesisë se denimit te shqiptoi nje denim sa me te bute dhe ti zbatoje dispozitat ligjre per zbutjen e dneimit nga neni 72 siq parashihet ne KPRK.

I pandehuri S.Z në fjalën përfundimtare deklaroi: pajtohem ne teresi me mbrojtësin tim dhe dua te shtoj sa i perket vepres penale armbajtje e kam pranuar dhe e pranoje prap, i kerkoje falje familes se te demtuareve per ate qe ka ndodhe, jemi pajtuar dhe nuk kemi asgje te keqe ne mes veti, e lus gjyaktën ta kete parasysh nje fakte sepse une e kam te semuar vajzen me nje semundje te rende dhe i nevojitet trajtim i vazhduesshem dhe ate ne Shkup- Sistine dhe Tirane , dhe familjen e kam lene me nje ndihme sociale me 6 anetare me 5 femije te vegjel dhe kjo ndihme sociale as per se afermi as vajzes nuk i mjatone per barna. Ne muaj ajo duhet 4 te marre terapi nga 300 euro nje terpai, dhe per kete gjyaktës ja dorezojme dokumentacionin mjeksor per vertetimin e ketij e tij fakti. Asaj i duhen edhe barna tjera por edhe fizioterapi, pastgaj ushqim ekstra, mbathje ortopedike ekstra etj.

Lidhur me vepren penale Lendim i lehte trupor siq e kualifikoi PTH une e pranoi fajsinë per kete veper penale.

Gjykata pas marrjes së deklarimeve nga prokurori dhe përfaqësuesi i të dëmtuarve e ka miratuar pranimin e fajsis nga i pandehuri për vepren penale Lendim i lehte ttupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 te KPRK.

#### **Provat që Gjykata i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor:**

Ne shqyrtimin gjyqësor gjykata ka dëgjuar në cilësi të dëmtuarit – dëshmitarit E.O i cili në shqyrtimin gjyqësor të dt 26.01.2024 deklaroi ; ne kete date une isha duke punuar ne tavolinen time te punes, e krevë derën qe isha duke e punuar, e thirra A.I qe te me ndihmoj ta heq derën, A.I me tha me mujt me msu zanatin edhe mos me ta rras mo, kjo ishte si nje lloj shakaje mes kolegve, aty filluam qe te qeshim mes neve dhe i thash mos u gut se mos po ngulesh, e kisha fjalën per ne pune. Nuk kemi ditur sen, kur S.Z filloj me sha, na nuk kemi qene duke folur me te dhe filloj te shaj dhe shkoj ne drejtim te fijoskut, e ka marr armen e ka repetit dhe ka marr ne tavolinen e tij nje qekiq dhe me ka gjuajtur, une kam qene tek tavolina e punes kur gjuajti vetem e kam ulur koken dhe ka ardhur ne drejtimin tim, me ka vendosur armen ne koke, ne ate moment duke ja hequr doren e ka shkrepur armen dhe me goditi ne pjesën abdominale. Ne ate moment me nuk kam pasur force, por vetem e kam shtyer dhe është kthyer nga A.I dhe ka shten poshte kah kembet – ne kembe. Pastaj ju është bllokuar arma, dicka shpurthke dhe te tavolina e punes



ka shkuar kah fijoku. Gati dy vjet e gjysme kemi punuar bashke ne nje tavoline.U ndajtem per shak te ketyre mosmarreshjeve, sepse per cdo gje me kritikonin mua si pergjegjes.

S.Z nga fijoku kur ka ardhur te une ka ardhur me arme ne drejtim timin dhe nuk ka gjuajtur dhe kur ma ka qit armen ne koke aty une duke ja largu doren jemi shtyer dhe ka kris arma,ja kam larguar doren qe e kishte armen te poshte, une qellimin e kisha qe tja largoj doren me arme – me ja largu te poshte. A.I ka qene afersisht 2 metra me andej dhe kur une S.Z e kam shtyer prej veti eshte kthyer ne drejtim te A.I dhe atij nuk ja ka drejtuar armen, por ka gjuajtur ne kembe.

Në pyetjen e prokurorit : a te kujtohet ne prezencen e V.K dhe A.I e qe prezent ka qene edhe S.Z a e keni perdorur shprehjen “deri sa pe marrin zanatin po ta marrin ne goje dhe pastaj nuk po ta marrin” a e keni thene kete?

Dëshmitari përgjigjet ; ne si koleg ne fillim kemi bere hajgare mes vete kur ishim mire me S.Z, kemi folur fjale si “ma shtine” “ta shtina” etj, por kur une S.Z i thoja beje mire punen ai me thoshte u kry drejtor, sepse her me thirrke her drejtor her shef e dikur edhe babe me thirrke. Ne jemi pajtuar ne mes veti.

**Ne shqyrtimin gjyqësor gjykata ka dëgjuar në cilësi të dëmtuarit - dëshmitarit A.I i cili në shqyrtimin gjyqësor të dt 26.01.2024 deklaroi :** Une mund te them se krejt telashia ka qenë dy deri në pesë minuta, dhe mund të them se nuk ka pasur fyerje, nuk është përmendur asgjë në rast për S.Z, ajo fjali që është fol, është fol gjithë në atë kompani në mes të kolegëve, ajo fjali që po pretendoj “jo po ja marrin ne goje shefit”, kanë qenë tri tavolina, E.O më thiri me i ndihmu në punën e tij, S.Z ka qenë mbrapa neve duke punuar punën e vet, unë e E.O kemi qenë duke bërë llaf të punës, unë i kam thënë E.O, edhe pak sa të mësohem e dua të iku jashtë, kjo ishte, edhe pas neve S.Z, u qu dhe ka shah të dy neve, dhe na është drejtuar “Qup, se po t’jau ... nanen”, ka shkuar tek dollapi i tij e ka gjuajtur me cekiq në kokë E.O dhe ka shkuar me allti e ka raportit dhe ju ka afru, janë shty me E.O për me kap armën E.O dhe me largu, dhe në atë moment ka shkrepur, u largu përmas, për afërsisht 3-4 metra, është kthyer nga unë dhe më ka shah me familje, dhe me vetdije të plotë ka gjuajtur në drejtim të meje. Në pyetjen e prokurorit ; Gjuajta me cekan a mund te na tregoni cfare lartësie ka qenë? S.Z, me dorën e djathtë e ka pasur armën, me dorën e majtë e ka kap E.O për teshave, edhe E.O tërë kohën ka insistu me ja kap armën me e hjek prej dorës së tij, dhe në atë moment duke u mundur të ja largoj prej dorës ka shkrepur arma.

Në pyetjet e prokurorit : a e keni vërejtur se a ka mundur me ja largu prej kokës armen E.O S.Z? përgjigjet; Po është mundu me ja largu armën, e kam parë që nuk ka mundur me ja heq armën prej dorës, por vetëm ja ka zhvendos poshtë trupit. Po e kam parë kur S.Z e ka marr armen në dollap, arma është raportit posa e ka marrë prej dollapit dhe ka shkuar me të. Njëherë ka shtënë

në E.O Nuk kam qenë më larg se 1.5 metra prej E.O kur ka shtënë S.Z në E.O. Po pasi ka gjuajtur S.Z , është larguar pak mbrapa në drejtim timin, dhe ashtu mbrapa, disi, më ka kaluar edhe une i kam mbet në ballë dhe më ka sharë dhe ka gjuajtur në drejtim timin, konkretisht në drejtim të këmbëve.Njëherë ka shtënë në drejtim timin,më nuk e di se cka u bë, e di se e kam shikuar këmbën me gjak.Kur S.Z ka shtënë nuk ka pasur ndonje pengesë.A është bisedu në prezencë të V.K, dhe a është përmendur fjala “deri sa pe marrin zanatin po ja marrin shefit në gojë, kur pe marrin zanatin mo nuk po ja marrin në gojë”? deshmitari u pëgjijg se “Po këto fjalë janë përmendur, amo V.K nuk e di që ka qenë prezent”.

Dëshmitari V.K në shqyrtimin gjyqësor dt.22.02.2024 deklaroi; Në puntorin “B...” punoi qe 7 vite punoj dhe S.Z, E.O dhe A.I i njoh, ata janë punëtor në këtë kompani dhe koleg të mijë. Në pyetjen e prokurorit se “A ju kujtohet me ndonjë rast kur keni qenë së bashku me E.O, A.I e S.Z e në bisede sipër është thënë nga E.O “ deri sa po ia marrim zanatin po ta marrin në goje dhe pastaj nuk po ta marrin” a e keni dëgjuar këtë”? , deshmitari thotë ; “Atë ditë që kam qenë unë aty kam shkuar te A.I për mi dërgu parat sepse ia kisha marr një ditë më herët për të ia kthyer ato të holla dhe e kam përfundu me A.I duke i ngjitur nalt me ka ndal E.O dhe ma ka thënë këtë fjalën që tha prokurori”. Ku ishte S.Z në këtë momente kur ta ka thënë këtë fjalë? S.Z ka qenë dikund më posht afërsisht 1 meter më larg, më shumë nuk ka qenë.

Kur e ka thënë E.O këtë fjalë kujt ia ka drejtu?Unë nuk e di për kënd e ka pasur fjalën por mua ma ka thënë këtë fjalë por nuk e di për kon. A të kujtohet pasi u dëgju kjo fjalë, pas sa kohe është shkaktuar incidenti? Përafërsisht 1 deri 2 minuta, pas kësaj fjale, ndoshta edhe më pak.

Në pyetjen e të pandheurit S.Z se : A ka qenë hera e parë që keni dëgju fjalë të tilla apo keni dëgjuar edhe ndonjë herë tjetër? Dëshmitari: Unë këtë e mbaj mend për herave tjera nuk e di mund të gaboj.

Dëshmitari B.A, në shqyrtimin gjyqësor dt.22.02.2024 deklaroi; Atë ditë kemi filluar punën në mëngjes si gjithë, kemi nejt në pauzë në ora 12:00 me S.Z, vetem ne të dy, dhe prap kemi vazhduar punën pas dite, edhe kta kanë qenë duke punuar, unë kam qenë në sektorin tim, secili ka qenë në tavolinën e vet, ndërsa S.Z, E.O nga unë kanë qenë 12-13 metra larg në vend pune, nga zhurma nuk dëgjohet dhe unë e kam ndëgjuar kur ka shkrep arma, dhe kam vrapuar te këta me pa se cka u bë. Kur kam shkuar te keta S.Z kishe qenë te tavolina e vet, jam afër në mënyrë të thjeshtë ia kam marr armën, nuk ka pasur ndonjë problem për ta ma jep armën dhe e kam marr e kamë futë në xhep armën. S.Z kishte qenë në këmbë me rovole në dorë.E.O në atë moment e

mbante barkun ndërsa A.I u mbështet për tavoline dhe e mbante këmbën.S.Z në momentin kur ja kam marr armën, nuk ka rezistuar. S.Z ka shtënë dy her.

Në pyetjen e mbrojtësit të pandehurit ; Meqenëse jeni puntor i vjeter, a e dini se cfarë raportesh kanë pasur para kësaj date? Përgjigjet ; Në fillim kanë qenë mirë, e pastaj pas nja dy vite jam keqësuar këto raporte dhe kanë filluar këto telashe, për punë, ti këtë e din, ti këtë nuk e di e kështu me radhë. Me sa uën e di për qito lidhur me punë se kush është shef e kush nuk është shef kanë pasur telashe.

I pandehuri S.Z e pyet dëshmitarin : A ma ke marr alltin apo ta kam dhënë unë vet kur unë ja kam hequr shanzherin dhe fishekun nga tyta ndërsa fisheket tjera kanë mbetur në okfir?

Dëshmitari: Po, ma ke dhënë vet alltin, ja ke heke fishekun nga tyta.

Dëshmitari E.F., në shqyrtimin gjyqësor dt.01.03.2024 deklaroi:Unë kam qenë njëri nga shefat e kompanis “B...” dhe E.O, A.I dhe S.Z kanë qenë puntor deri në momentin e ngjarjes dhe për një periudhë të shkurtër S.Z ka ardhur me vonë dhe logjikisht është dashur ta dëgjojë E.O, ndersa më vonë kanë qenë të pavarur, dhe ne momentin që ka ndodhur rasti sepse i kanë pasur tavolinat e veta te punës dhe normal kur S.Z ka dal ne tavolin do të thotë se është avancuar.

Në pyetje të prokurorit se ; a ka qenë ndonjhere ne zyren e juaj për tu ankuar ndonjeri nga këta tre për shkak të provokimeve ne punë?Përgjigjet po, kanë qenë per ndonje problem të vogël por nuk e mbaj mendë .Në pyetjen tjeter : a është anku ndonjeri prej këtyre treve, sepse kinse për shkak të avansimit ne vendin e punes eshet provokuar nga kolegu me fjale “ deri sa pe marrin zanatin, po ta marrin ne gojë dhe pastaj nuk po ta marrin”?Përgjigjet nuk i kam dëgjuar këto fjale asnjhere, nuk ka ardhur dikush që ti mi thote keto fjale.

Në pyetjen e mbrojtësit : a jeni ju personi që e keni hjekur nga tavolina S.Z dhe e keni caktuar ne nje tavoline tjeter nga E.O?po në bashkpunim me menagjerin e prodhimit A.A, për arsye te avansimit.

Në pyetjen e të pandehurit S.Z : së pari kërkoj falje per krejt cka ka ndodhur atu, po atë kujtohet deri sa erdha, rasti kur ti na dergove ne zyren tende pas nje mosmarrevshje që e kishim rreth disa klipsave që i mshefte E.O dhe na the “ nëse edhe nje problem më i vogël, nuk më vveni asnjeri këtu”?Përgjigjet ; po me kujtohet kjo që jua kam terhjekur verejten.Një lloj provokimi ka qenë dhe ka qenë ankesa rreth provokimit ndaj S.Z. S.Z ka qene me i shpejte ne punë dhe më efektiv ne punë.

Kryetari i Trupit gjykues, shtron pyetje: a keni vërejtur ju si shef-mbikqyrës i repartit se në mes të S.Z dhe E.O kanë pasur telashe apo e kanë provokuar S.Z? Pergjigja;po pak a shumë e kam ditur per disa provokime por se kam ditur që të vije deri në këtë nivel.

**Provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor:**

**Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.01.03.2023 janë administruar provat materiale si në vijim:**

Ekspertiza –mjeko ligjore për të dëmtuarit dt. 12.10.2023 nga Instituti i Mjeksis Ligjore me konstatimin se i demtauri E.O ka Lendime te renda trupore ndersa i demtauri A.I lendime të lehta trupore. Raporti fillestar i incidentit dhe raportet poicore; Raporti i kqyrjes së vendit të ngjarjes i dt. 27.06.2023; fotoalbumi i vendit të ngjarjes; Fletlëshimi nga QKUKpër të dëmtuarin E.O; Fletlëshimi nga QKUKpër të dëmtuarin A.I.

Raporti i ekspertimit menr reference AKF /2023-2144/23-1992 dt. 03.08.2023; Fotodokumentacioni në shkresat e olëndës; CD-ja nga vendi i ngjarjes e administruar drejtpërdrejt në shqyrtim gjyqësor.

**I pandehuri S.Z** në sencen e shqyrtimit gjyqësor të dt. 01.04.2024 ka deklaruar se;E.O ma ka pas pru shpreditin ne fyt me fjalë fyese ose provokuese ndaj meje, dhe pasi që unë dola në tavolinën time dhe punoja vetëm, E.O ia heqën Premidoren prej dore dhe i thanë se ti je shume i ngadalshëm, bile ja rroploj kështu për tok duke i dhënë vërejtje se “ ton ditën tri copa nuk po mund te i qet” dhe atë ia beri kryepuntori.Pas pak kohe erdhi shefi E.F dhe i tha pse nuk po ece puna këtu , cka është problemi këtu që po kryhen vetem tre, ai tha “ unë nuk po mundme më shume sepse deri po e ngjes gomën po ka shumë punë dhe **nuk po mundem me shumë”** , E.F mua më tha duhesh të vish deri ne zyre dhe me tha me marr premidorin komplet ne dore ti dhe me rriti rrogën per **100 euro me shumë, prapë se prap une nuk emaerrja premidorin spese** E.O e disha që xhelozon dhe do të kem problem me të, nje ditë prej ditësh duke kaluar shefi atu me tha E. shefi me ke borxh deri sa të e merrsh me e kry edhe krahin , une u ngushtove dhe ja nisa me punu edhe krahin, dhe i thash E.O se vëlla po më vie keq se nuk i kisha marr në dore këtë punë, por e din se qysh e kom punën keq me qikë sepse e kam vajzën e sëmure dhe me duheshin para më shume per mjekimin e vajzës. Ja kam fillaur të punoj krahët dhe me kujtohet ditën e parë i kam perfunduar katër apo pesë krahë, dhe duke e mësuar A.I ne anën tjetër dhe isha këmbngulës që A.I ta meson zanatin dhe A.I arriti ta mesoj këtë pune, pastaj E.O pikërisht për këta të më gjuaj

fjalë shumë të rënda fyese, une punpja edhe pas orari edhe te dieleve kurdo që kish nevojë ndërsa E.O u shprehke me fjalë fyese gjoja se po i serfilohesh shefave pse unë po punoj.Në ditën kritike unë isha nje m atër tij edhe pse i kisha thene A.I mos mi afro ato per me i kry afer E.O sepse po gjuan me fjalë, atë ditë une isha duke e kryer nje Premidor ka kaluar atu pari V.K i cili është tezak i E.O dhe E.O e ka thirrur V.K dhe i njejt i u afrua dhe i tha deri sa po e marrin zanatin po ta marrin ne goje ndërsa kur per marrin zanatin jo” jam prekur fort dhe jam qu nga atu i kam marru mjetet me i qu tek tavolina dhe i kam thënë “ Qup, pis” me ka shajtur , e kam marrur nje daltë dhe e kam gjuajtur, të betohem se kur e kam hapur viokun e kam parë revolen se eshte atu dhe e kam marrur dhe nuk e kisha qëllimin për ta vrarë as të e shkrepri hiq, ju kam afruar afër e kam kapur për tesha, e kam gju për tavoline, e mbante nje qekiq në dorë, i kam thënë “pse po flliq me gojë o pis, apo don me ta shkri plumin në gojë” jam kam drejtaur revolen por nuk kam dashur ta gjuaj, e verjti edhe ai se nuk po du me gju dhe filluam te shtyehmi ne armë me të dhe ne shtyrje e sipër ka shkrapur revolja, pa dashjen time. Jam kthyer, jam humbur totalisht dhe e kam parë A.I tu ardhë ne drejtimin tim isha komplet i humbur dhe ja kam drejtuar revolen ne drejtim te kembeve dhe e kam shkrepur.

Në pyetjen e avokatit : sa plumba i ke pasur ne revole dhe sa i ke shkrepur dhe sa ka qenë largesia nga kaseta deri tek E.O?, përgjigjet, i kam paur 6 plumba ne revole, dy i kam shkrepur, ndërsa largesia nga kaseta ka qene diku 3-4m.A është e saktë se armen e keni marrur pasi që keni gjuajtur me daltë? Pergjigjet ; me sa me kujtohet mua armën e kam pasur ne dorën e djathtë ndërsa me doren e mjate e kam gjuajtur me daltë. Armën me të marr në dollap a e raportitët?:po, pastaj e kam kapur daltën.Pse e raportitët armën? ; me qëllim që ta frigoj që mos të provokojë më .A ke pasur mundësi me u largu nga vendi i punës dhe mos me shku te dollapi ku e ke pasur arëmën?; po kam pasur mundësi.Provokimet në ditën kritike janë bërë nga ana e E.O, pse shtëne ne A.I?

dy javët e fundit filloi edhe ai ta përkrahte E.O dhe me provokojshin bashke dhe pasi që e plagosa E.O ai me erdhi ne drejtim timin dhe une jam friguar se pom bjen me diqka, hekur apo diqka.A vetem je frikësu apo ka pasur ne dore diqka?po ka pasur dicka në dorë. Cka ka pasur në dorë?, ka pasur qekiq në dorë.A e thene edhe ne prokurori se A.I ka pasur qekiq në dore? po e kam potencuar.A keni dhënë deklaratë ne Polici për kete rast?po kam dhënë.

Prokurori ; a është e saktë kur keni deklaruar se “ata më shajtën që të dy, atëherë unë i gjuajata me diqka deri sa isha duke i shtënë aletet ne orman dhe atu e kisha nje revole te babës që e kisha lënë më herët, e morra revolen nga ormani me qëllim me i tut...” a është kjo e saktë?po. A.I a të ka goditur me qekiq?jo.Armën a ja ke drejtuar në kokë E.O?po Gishtin a e keni pasur ne

këmbezen e armes?nuk jam i sigurtë, por nuk e kisha qëllimin që të gjuaj.A ke pas pengesa me u gjujt me armë në dysHEME?jo.

Në pyetjen e përfaqësuesit të dëmtuarit E.O, Av.Fatbardh Makolli; ju deklaruat se E.O të kapur për tesha dhe se E.O e mbante një qekiq, kur u afrove me revole dhe ja drejtove revolen në kokë, si rezistoi ai?Përgjigja; ma kapi revolen dhe e shtyji teposhtë , kur e ka shtyrë teposhte me siguri e kam shti gishtin tek këmbëza dhe e kam shtënë, unë e kam kapur E.O për tesha e jo E.O mua, me dorën e majtë ma ka kapur revolen.

Në pyetjen e Kryetari i Trupit gjykues: revolen kur e ke sjellur në punëtori atë ditë apo ndonjë ditë tjetër?. I pandehuri: revolen e kam lënë atë kur më ka vdekur baba dhe atë ka qendëruar dhe nuk e kam marrur me veti, sepse me lënë në shtëpi u tutsha që fëmijët po e prekun.

#### **Gjetjet e Gjykatës lidhur me faktet jo kontestuese dhe faktet kontestuese**

##### **Faktet jo kontestuese:**

Nuk ishte kontestuese fakti se i pandehuri S.Z punonte kompanin “B...” dhe se punonin në një objekt me të dëmtuarit E.O dhe A.I dhe në një moment ishin ndarë në tavolina të veçanta për të punuar..

Nuk ishte kontestuese se ata deri në ditën kritike kishin pasur mosmarveshje e cila kishte të bënte rreth një fjalie e që i pandehuri S.Z e kishte marrë si provokim .

Rezulton se nuk ishte kontestuese se ata atë ditë para rastit kishin filluar një sharje në mes veti.

Në një formë nuk ishte kontestuese as fakti se i pandehuri pas disa fjalëve nis të drejtohet në drejtim të dollapit së tij ku i kishte sendet e veta , e më pas revolen e repetit dhe pastaj e kap një daltë dhe prej një distance 5-6 metra e hudoi në drejtim të E.O e që është një rrethanë shumë relevante lidhur me vertetimin e elementit subjektiv – mens-rea, kjo për faktin se edhe i dëmtuari edhe i pandehuri theksuan në shqyrtim gjyqësor se “ ka gjuajtur me një daltë”.

Nuk ishte kontestuese se i pandehuri S.Z pasi që e gjuan me daltë, shkon me revole në dorë i ofrohet të dëmtuarit E.O dhe fillojnë të shtyhen në mes veti dhe në një moment i pandehuri S.Z ja ofron revolen afër kokës të dëmtuarit E.O dhe i dëmtuari me dorë mundohet t’ja largoi revolen duke ja ulur poshtë dhe në një moment arma kërsët dhe e godet në abdomen të dëmtuarin E.O e

që edhe kjo është një rrethanë shume relevante lidhur me vertetimin e elementit subjektiv – mens-rea.

Nuk ishte kontestuese se i dëmtuari E.O mori plag në abdomen.

Nuk ishte kontestuese as fakti se i pandehuri S.Z menjher kthehet dhe e sheh A.I dhe e drejton revolen në drejtim të këmbëve të A.I dhe shtënë një her të cilin e godet në këmbë, këtë fakt e thotë edhe vet i dëmtuari A.I.

Gjykata këto fakte përveq që ishin të pakontestuar këto fakte vertetohen edhe nga deklaratimet e të dëmtuarve dhe deklarimi i të pandehurit deklarimet e dëshmitarve por edhe nga provat materjale e që të gjitha krijojnë një lidhje logjike në vertetimin e këtyre fakteve.

Andaj, Gjykata i merr të vërtetuara faktet e sipër cekura dhe nuk e sheh të nevojshme të lëshohet në arsyetimet e mëtejme lidhur me këto fakte të cilat edhe nuk janë kontestuar nga palët e as nga përfaqësuesit e tyre.

#### **Faktet kontestuese**

*Fakt kontestues në këtë rast ka qenë, se i pandehuri me veprimet e tij ditën kritike a kishte qëllimin dhe dashjen për t'a privuar nga jeta të dëmtuarin E.O, pra lidhur me veprën penale nën piken –I- ?*

#### **Vlerësimi i provave dhe besueshmëria e tyre**

Gjykata në pajtim me dispoziten e nenit 361 të KPP-së, ka vlersuar të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku në lidhmërin e tyre me ndërgjegjëje lidhur me relevancën e tyre, besueshmërin e tyre dhe fuqinë provuese të secilës provë dhe lidhjen logjike të tyre si tërësi dhe ka nxjerrur përfundimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata ja ka falur besimin deklaratimit të dëmtuarit E.O në pjesën kur deklaroi se;'' kur S.Z filloj me sha, .... dhe shkoj ne drejtim te fijoskut, e ka marr armen e ka repetit dhe ka marr ne tavolinen e tij nje qekiq dhe me ka gjuajtur, une kam qene tek tavolina e punes kur gjuajti vetem e kam ulur koken dhe ka ardhur ne drejtimin tim, me ka vendosur armen ne koke, ne ate moment duke ja hequr doren e ka shkrepu armen dhe me goditi ne pjesen abdominale.

Gjykata kësaj pjese të deklaratimit të të dëmtuarit E.O ja falë besimin sepse përputhet me një pjesë të deklaratimit të të pandehurit S.Z sidomos në pjesën kur deklaroi se '' atë ditë une isha duke e

*kryer nje Premidor ka kaluar atu pari V.K i cili është tezak i E.O dhe E.O e ka thirrur V.K dhe i njeiti u afrua dhe i tha deri sa po e marrin zanatin po ta marrin ne goje ndërsa kur per marrin zanatin jo” jam prekur fort dhe jam qu nga atu i kam marru mjetet me i qu tek tavolina dhe i kam thënë “ Qup, pis” me ka shajtur , e kam marrur nje daltë dhe e kam gjuajtur, të betohem se kur e kam hapur viokun e kam parë revolen se eshte atu dhe e kam marrur dhe nuk e kisha qëllimin për ta vrarë as të e shkrepi hiq, ju kam afruar afër e kam kapur për tesha, e kam gju për tavoline, e mbante nje qekiq në dorë, i kam thënë “pse po flliq me gojë o pis, apo don me ta shkri plumin në gojë” jam kam drejtaur revolen por nuk kam dashur ta gjuaj, e verjti edhe ai se nuk po du me gju dhe filluam te shtyehmi ne armë me të dhe ne shtyrje e sipër ka shkrpur revolja, pa dashjen time. Jam kthyer, jam humbur totalisht dhe e kam parë A.I tu ardhë ne drejtimin tim isha komplet i humbur dhe ja kam drejtuar revolen ne drejtim te kembeve dhe e kam shkrepur”.*

Ky deklaram i të dëmtuarit E.O përputhet pjesërisht edhe me deklaramin e të dëmtuarit tjetër A.I kur deklaronte se “S.Z, me dorën e djathtë e ka pasur armën, me dorën e majtë e ka kap E.O për teshave, edhe E.O tërë kohën ka insistu me ja kap armën me e hjek prej dorës së tij, dhe në atë moment duke u mundur të ja largoj prej dorës ka shkrepur arma.”.

Gjykata ja ka falur besimin e plot provave materjale nga se si të tilla vërtetojnë tërsin e rrethanave faktike e po ashtu në lidhshmërin e tyre janë logjike, konstante dhe të qëndrueshme dhe njëkohisht si të tilla këto prova të cilave ua ka falur besimin gjykata i bëjnë të qëndrueshme deklaramet e dëshmitarve dhe të pandehurit për rrethanat e tilla siç gjykata ka argumentuar se per ç’far arsye dhe në cilat pjesë ua ka falur besimin atyre deklaramave.

Provat materjale që gjykata ua ka falur besimin e plotë janë ; **ekspertiza mjeko-ligjore** ku konstatohen lloji i lendimeve për secilin të dëmtuar, pra kjo provë verteton një fakt shumë të rëndësishëm pikrisht pasojat e veprimeve të të pandehurit e që janë konstatuar se pasoja lidhur me të dëmtuarin E.O është dëmtime të rënda trupore të rrezikshme për jetën në momentin e shkakimit dhe kjo është prova që e verteton kauzalitetin e veprimeve të të pandehurit me pasojen e shkakuar që në rastin konkret ka relevance – rëndësi të plotë.Ndersa lidhur me të dëmtuarin A.I dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkoshme shëndetsore.

Një besim ua ka falur edhe **raporteve mjeksore** lidhur me të dëmtuarin E.O dhe të dëmtuarin A.I e të cilat janë administruar ne shqyrtim gjyqësor e te cilat përmbledhen me ekspertizen e Institutit të mjeksis ligjore – si organ kompetetn ligjor për dhenjen e konstatimeve profesionale.

Për gjykatën mbretresh e provavë është CD-ja e administruar në shqyrtimin gjyqësor ku shihen kjart se si fillon fjalosja , pastaj i pandehuri drejtohet drejt dollapit të tij ku i kishte sendet e veta e merr revolen e repetit pastaj e kap një daltë dhe menjher e gjuan në drejtim të E.O ndersa ne dorë e mban revolen dhe



shkon në drejtim të E.O dhe fillojnë të shtyhen në mes veti , (ndersa pjesa se si ja ka mbajtur revolen afer kokes nuk shihet sepse kamera pengohet nga një objekt – dritare që ishte pran duke u montuar )shifet kur i dëmtuari goditet ne abdomen dhe largohet ndersa nga ana tjetër i ofrohet i dëmtuari A.I dhe në atë moment i pandehuri kthehet nga A.I dhe e drejton revolen në drejtim kah toka dhe shtënë një her dhe e godet A.I në këmbë.

Gjykata përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri në puntorin “B...”për shkak të fjalve fyese në mes tyre i pandehuri S.Z shkon në drejtim të dollapit ku i kishte sendet e veta e mer revolen e repetit dhe pastaj me nje daltë e gjuan E.O dhe drejtohet në drejtim të tij fillojnë të shtyhen duke ja drejtu revolen dhe duke u shtyrë i dëmtuari E.O ja ulë doren në të cilen e kishte i pandehuri dhe në një moment revolja kërset duke e goditur E.O në abdomen.me këtë rast i dëmtuari pëson dëmtime të rënda trupore

Gjykata pasi qe ka bere administrimin e provave ne shqyrtimet gjyqësore ka ardhë ne përfundim se në veprimet e të pandehurit ditën kritike nuk përmbushën elementet e veprës penale vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 te KPK-se, pasi që nuk mund të vërtetohet dashja e tij për ta privuar nga jeta te dëmtuarin E.O.

Sipas vlerësimeve të gjykatës disa rrethana të ngjarjes që është zhvilluar tregojnë se qëllimi dhe dashja e të pandehurit nuk ka qenë e orientuar që te privoj nga jeta të dëmtuarin E.O dhe atë për faktet si në vijim;

E para gjykata verteton faktin se pas shkëmbimit të fjalve fyese në mes palve i pandehuri S.Z niset drejt dollapit të tij ku i kishte sendet e veta, e merr revolen e repetit , por nuk gjuan , ai gjuan me nje daltë e jo me revole

E dyta i pandehuri prej vendit ku ka gjuajtur me daltë ishte 3-4 metra dhe nga kjo largësi kishte mundësi të gjuaj me revole por nuk gjuajti.

E treta pasi u ofrua dhe filluan të shtyhen me të dëmtaurin me duar i pandehuri edhe pse ja kishte drejtuar revolen në kokë ai nuk shtiu por vazhduan të shtyhen ashtu që i dëmtuari arrin t’ja ulë doren në të cilen e kishte revolen dhe në një moment kur dora me revole ulet në nivelin e abdomenit kërset revolja

Për më teper në revolen e të pandehurit kishte ende fishek dhe kishte mundësi të shtën në të dëmtuarin E.O por nuk shtiu më , por u kujdes duke shikuar që nga ana tjetere rpo i afrohej A.I dhe e drejtoi revolen në drejtim të këmbëve të tij dhe e godet në këmbë.

I pandehuri nuk rezistoi por ja dorzoi revolen kolegut te tij

Gjykata gjenese këto fakte vertetojn se nuk ishte dashja e privimit nga jeta, për më tepër Gjykata gjen se veprimet e të pandehurit ditën kritike nuk kanë qenë të përgatitur apo planifikuara, ngjarja ndodhi për shkak të provokimit nga ana e të dëmtuarve duke përdorur fjalën ‘*deri sa po e marrin zanatin po ta marrin ne goje ndërsa kur për marrin zanatin jo*’

Gjithashtu i pandehuri nuk ka vazhduar të shtënë as nuk ka tentuar të shtënë më tepër edhe pse këtë e kishte të mundur kishte edhe 4 fishek në revole. Gjykata kishte parasysh që revolva ishte mjet i përshtatshëm për të shaktuar pasoja të rrezikshme për të dëmtuarin,

Sipas bindjes së gjykatës e cila mbështetet në provat e administruara gjatë gjyqimit dhe deklaratave të të dëmtuarit dhe dëshmitarëve rrjedh se veprimi i të pandehurit ditën kritike (goditja e të dëmtuarit siç ceket në dispozitiv të këtij Aktgjykimi) ka qenë një reagim për shkak të fjalve fyese, pra, reagim i momentit.

Gjykata nuk përjashton dashjen e të pandehurit për shkakimin e lëndimeve trupore të të dëmtuarit. Megjithatë nuk mund të vërtetohet se ka ekzistuar dashja e të pandehurit për ta privuar nga jeta të të dëmtuarin E.O, për arsyet e lartcekura, pra,;

- I pandehuri nuk gjuajti me revole edhe pse e kishte të repetitur, por gjuajti me daltë.
- I pandehuri në një distance 4-5 m me të dëmtuarin nuk gjuajti prap me revole por shkoi dhe filluan të shtyhen fizikisht në mes veti.
- I pandehuri edhe pse e kishte të drejtuar revolen në drejtim të kokës së të dëmtuarit ai nuk shtiu deri në një moment kur i dëmtuari ja uli doren në nivelin e abdomenit ku në shtyrje e sipër i pandehuri shtënë dhe e godet në abdomen.
- I pandehuri nuk vazhdoi të shtë në drejtim të E.O edhe pse i kishte edhe 4 fishek në revole.
- I pandehuri më herët nuk kishte bërë ndonjë përgatitje- plan për kryerjen e vrasjes apo diçka të ngjashme, reagimi i të pandehurit në atë mënyrë ka qenë aty për aty, andaj në këtë kuptim nuk mund të bindemi se ka ekzistuar dashja e tij, në raport me veprën penale të vrasjes në tentativë ndaj të dëmtuarit E.O ashtu siq e rikualifikoi prokurori në fjalën përfundimtare.,

Si përfundim gjykata, ka konstatuar se në veprimet e të pandehurit, nuk përmbushën elementet e veprës penale: Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPK-se, kjo pasi që mungon elementi konstitiiv dhe subjektiv i kësaj vepre penale që ka të bëjë me dashjen e të pandehurit tek kjo vepër penale.

### **Rikualifikimi i veprës penale nën pikën –I- :**

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare e ka bërë rikualifikimin e vepres penale nga dispozitivi –I- i aktakuzes pra nga vepra penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 173 par 1 nënpar 1.5 e

1.11 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së në veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së lidhur me të dëmtuarin E.O.

Trupi gjykues i ka vlerësuar pretendimet e prokurorisë në raport me përshkrimin faktik të ngjarjes së rikualifikuar pas administrimit të të gjitha provave kjo gjykatë ka vlerësuar se nuk ka rezultuar vepra penale e rikualifikuar nga prokurori në fjalën përfundimtare , andaj në këtë kuptim sipas KPP-së, Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale. Kjo sipas nenit (360 par.2 të KPP).

Gjykata është e bindur se në veprimet e të pandehurit S.Z, përmbushen të gjitha elementet e veprës penale: Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par 3 nënpar 3.2 e lidhur me par 2 nënpar 3.1 të KPRK-së , pasi që i akuzuari ditën kritike të dëmtuarit E.O i ka shkaktuar dëmtime të rënda trupore me përdorimin e revoles , andaj mbi bazën e këtyre rrethanave të konstatuara nga shqyrtimi gjyqësor pas administrimit të provave materiale dhe personale, Gjykata vendosi të rikualifikoj veprën penale, nga vepra penale: Vrasje në tentativë nga neni 172 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, në veprën penale: Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par 3 nënpar 3.2 e lidhur me par 2 nënpar 3.1 të KPRK-së sa i përket pikës –I- të dispozitivit.

Trupi gjykues në këtë rast ka ndryshuar përshkrimin e gjendjes faktike për të pandehurin S.Z në raport me veprën penale nën pikën –I- , pra gjykata në përshkrimin faktik nuk ka ndryshuar identitetin subjektiv të veprës penale, nuk ka ndryshuar përmbajtjen esenciale të akuzës për këtë veper të rikualifikuar nga prokurori i shtetit , në raport me kohën, vendin, të pandehurin, përveç se ka ndryshuar rrethanat të cilat i ka provuar në shqyrtimin gjyqësor, andaj edhe ka rezultuar me një kualifikim tjetër ligjor.

Mbi bazën e provave të administruara, trupi gjykues në këtë aktgjykim ka dhënë arsye të mjaftueshme për secilin fakt të vërtetuar. Sipas vlerësimit të gjykatës kjo situatë është e rregulluar me nenin 360 par.2 dhe 361 të KPP.

Trupi gjykues duke u mbështetur në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, i ka vlerësuar me ndërgjegje një nga një dhe në lidhshmëri të të gjitha provave ka ardhur në përfundim se i pandehuri S.Z , nuk e ka kryer veprën penale; Vrasje në tentativë nga neni 172 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, siq e ka rikualifikuar prokurori në fjalën përfundimtare, por në veprimet e tij ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale: Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par 3 nënpar 3.2 e lidhur me par 2 nënpar 2.1 të KPRK-së, për faktin se i njëjti me datën 27.06.2023 rreth orës 13.52 min në fshatin S...-Komuna e Vushtrris saktësisht në kompanin “B...” me dashje i ka

shkaktuar lëndime të renda trupore të dëmtuarin E.O, ashtu që pas një mosmarrveshje të atqasëshme, fillimisht i pandehuri hedhë një qekan në drejtim të dëmtuarit, pastaj nisjet drejt dollapit përsonal ku i kishte gjësendet e tijë nga ku e nxjerr revolen e tipit “Ceska Zbrojovka “ model 50, e cal, 7.65 x17 mm me nr serik C... të cilen e reperton aty për aty dhe ja drejton në kokë të dëmtuarit E.O, i cili në atë moment tenton t’ja kap armen nga duart dhe e shtynë poshtë, e në atë moment i pandehuri shtie në drejtim të dëmtuarit E.O ku predha e godet në pjesen e abdomneit – barkut me që rast të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor dhe të rrezikshëm për jeten në momentin e shkaktimit, për çka gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptojë dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi nën piken –I-.

**Lidhur me veprën penale Lendim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 e lidhur me par 1 të KPRK-së dhe veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par 1 i KPRK-së** gjykata gjenë se i pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajsin për veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par 1 i KPRK-së të cilin pranim gjykata e ka miratuar sepse përputhej plotsisht me provat në shkresat e lëndës. I pandehur lidhur me dispozitivin e ri të krijuar nga prokurori i shtetit ne fjalën përfundimtare lidhur me të dëmtuarin A.I duke e akuzuar të pandehurin për veprën penale Lendim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 e lidhur me par 1 të KPRK-së në raport me A.I , i pandehuri menjher e ka pranuar fajsinë dhe gjykata e ka miratuar pranimin e fajsis nga ana e të pandehurit edhe për këtë veper penale sepse siç u elaborua më lartë këtë e vertetojë të gjitha provat e administruara nga gjykata e sidomos CD-ja e administruar në shqyrtimin gjyqësor Për gjykatën mbretresh e provavë është CD-ja e administruar në shqyrtimin gjyqësor ku shihen kuart se si fillon fjalosja , pastaj i pandehuri drejtohet drejt dollapit të tij ku i kishte sendet e veta e merr **revolen** e repetit pastaj e kap një daltë dhe menjher e gjuan në drejtim të E.O ndersa ne dorë e mban revolen dhe shkon në drejtim të E.O dhe fillojnë të shtyhen në mes veti , (ndersa pjesa se si ja ka mbajtur revolen afer kokes nuk shihet sepse kamera pengohet nga një objekt – dritare që ishte pran duke u montuar )shifet kur i dëmtuari goditet ne abdomen dhe largohet ndersa nga ana tjetër i ofrohet i dëmtuari A.I dhe në atë moment i pandehuri kthehet nga A.I dhe e drejton revolen në drejtim kah toka dhe shtënë një her dhe e godet A.I në këmbë . Andaj përtej çdo dyshimi gjykata verteton faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par 1 i KPRK-së dhe veprën penale Lendim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 e lidhur me par 1 të KPRK- për të cilat edhe i ka pranuar i pandehuri.

**Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit;**

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i pati parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për secilen veper penale të akuzuarin e ka shpallur fajtor, pastaj pati parasysh parime mbi të cilat duhet bërë matja e dënimit, proporcionalitetin e dënimit me pasojen –rrezikimin e vlerës së mbrojtur, pastaj qëllimin e dënimit dhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga neni 70 të KPRK-së, që ndikojnë në ashpërsimin ose zbutjen e dënimit:

**Për të akuzuarin gjykata gjeti këto rrethana rënduese dhe lehtësuese;**

Si rrethana rënduese gjeti:

- shkallen e pjesëmarrjes se tij ne kryerjen e veprës penale, pasi qe siç edhe u elaborua dhe u vertetua, i akuzuari armen e kishte në dollapin e veglave ku punonte.
- intensitetin e rrezikimit apo te dëmtimit te vlerës se mbrojtur, pasi qe ne rastin konkret goditet i dëmtuari i parë dhe atë në abdomen e pastaj edhe i dëmtuari i dytë.

Si rrethanë lehtësuese gjeti:

- rrethanat e tija personale se i njejti i martuar jetonte me nënen e tij e cila gjate kohes sa ishte në paraburgim i ka vdekur, ka 5 fëmij të mitur, për më teper gjykates i ka dorzuar dokumentacionin mjeksor për vajzen që e ka të smure dhe në një gjendje shume të rëndë me një diagnoze që kërkon shpenzime të mëdha dhe terapi përmanente dhe trajtimi duhet ne Shkup ose diku jashte vendit, ishte në një gjendje ekonomike te vështirë dhe është i moshes relativisht te re.
- prokuroria nuk dëshmoi se kemi ndonjë aktgjykim denues të formës së prer lidhur me të pandehurit.

Ne rastin konkret bazuar në këto rrethana gjykata vendosi që të përcaktoi minimumin e parapare ligjore sa i përket veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par 3 nënpar 3.2 e lidhur me par 2 nënpar 2.1 të KPRK-së.

Po ashtu,bazuar në këto rrethana gjykata ndaj të pandehurit, shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK-së, pasi që ka konsideruar që me këtë do të arrihet qëllimi i dënimeve, pasi që për të njejtën vepër penale i pandehuri e ka pranuar fajësinë qysh në seancën e shqyrtimit fillestar, e po ashtu gjykata ka gjetur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit për këtë vepër penale mbështetet në faktet dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e në të cilat është mbështetur aktakuza.

**Lidhur me veprën penale** Lendim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 e lidhur me par 1 të KPRK-Gjykata bazuar në rrethant e specifikuara dhe të individualizuara një nga një e bazuar në faktin se menjher pasi prokurori e bëri rikualifikimin i njëjti pa hezitim e ka pranuar fajsin për këtë veper penale , por kjo mbështetet në faktet dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke u nisur nga fakti se gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënim me burgim për tri veprat penale, në mbështetje të nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.2 të KPRK-së duke shqiptuar ndenimin unik me burgim si në dispozitiv.

Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprat penale me të cilat akuzohet i pandehuri dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, se i pandehuri në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

***Lidhur me paraburgimin:***

Të akuzuarit koha e kaluar në masën e paraburgimit prej dt.27.06.2023 deri me dt.04.03.2024, i llogaritet në dënimin e shqiptuar unik me burgim.

***Lidhur me konfiskimin:***

Gjykata, në mbështetje të nenit 276 të KPP-së, nga i akuzuari në mënyrë të përhershme konfiskohet Arma-revole e tipit “Vzor”50 cal 7.65 mm me nr serik C..., të cilën pasi që aktgjykimi të merrë formën e prerë do të shkatërrohet nga Policia e Kosovës.

***Lidhur me shpenzimet e procedurës penale:***

Gjykata e ka detyruar të akuzuarin që t’i paguajnë shpenzimet e procedurës penale duke u mbështetur në nenet 449 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 36 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin për udhëzimin e palës të dëmtuara që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest të rregullt civil gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Gjykata, nga arsyet e cekura si më lartë e bazuar ne nenin 364 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti për Krime të Rënda**

**P.nr.150/2023 dt.25.03.2023**

**Procesmbajtësja:**

**Shukrije Selimi**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:**

**Ali Kutllovci**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa, i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.